

**STATUTI I
SHOQËRISË ME PERGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ALESSIO MONTI DISTRIBUZIONE” SH.P.K.**

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 104.2008 "Per Tregtaret the Shoqerite Tregtare".
- "Statuti" eshte Statuti i shoqërisë
- "Dite të Plota" ne lidhje me periudhen e një njoftimi eshte periudha që nuk e perfshin diten kur eshte dhene ose kur konsiderohet se eshte dhene njoftimi dhe ditën për të cilën eshte dhene ose hyn në fuqi njoftimi.

KREU I

**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA DHE ADRESA E FAQES SE
INTEMETIT**

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesi

- 1) Sot, me 25/11/2022, une themeluesi, kam hartuar statutin e ri te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emrin **“Alessio Monti Distribuzione” Sh.p.k.**, te themeluar me 25/11/2022.
- 2) Themeluesi i shoqerise eshte:
 - Znj. Besmira Rrika, shtetase shqiptare, e lindur në Zheje - Kruje, më 22/10/1992, banuese në Zheje - Kurbin, madhere, me zotesi te plote për të vepruar, i pajisur me numer Karte Identiteti: Nr. J26022085W.

Neni 2

Objekti

Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi:

- Tregtia me shumice e aparateve celulare dhe aksesoreve.

Neni 3

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqërisë do te jete a pacaktuar.

Neni 4

Selia, Adresa e Faqes së internetit dhe Adresa Elektronike

- 1) Selia e shoqërisë ndodhet në: **Rruga “Sami Frasher”, Pallati i Shoqerise Alion, Kati 3, Ap. 2, Tiranë, Shqiperi.**



KREU II KAPITALI I REGJISTRUAR

Neni 5

Vlera dhe Pagesa e Kapitalit të Regjistruar

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000,00 (njeqindmije) lek.
- 2) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë përbëhet nga 1 kuote me vlerë 100%.

Neni 6

Kontributet

- 1) Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si mëposhtë:
 - Znj. Besmira Rrika, shtetase shqiptare, e lindur në Zheje - Kruje, më 22/10/1992, banuese në Zheje - Kurbin, madhore, me zotesi te plete për të vepruar, i pajisur me numer Karte Identiteti: Nr. J26022085W, 100 % me një vlerë nominale prej lek 100.000,00 (njeqindmije).
- 2) Sipas, kontributeve të mësipërme:
 - Shoqerise "Alessio Monti Distribuzione" SH.P.K, i përkasin Znj. **Besmira Rrika** 100 %, e kuotave të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 7

Rritja dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

- 1) Asambleja e Pergjithshme, me shumicë to kualifikuar, mund të zmadhoje kapitalin themeltar te shoqërisë duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues ne shumen e percaktuar ne vendimin perkates. Zmadhimi i kapitalit me qellim pranimin e ortakeve to rind ne shotteri, miratohet nga Asambleja e Pergjithslune me shumicen e kualifikuar te votave të ortakeve.
- 2) Shoqëria mund te vendose zvogelimin e kapitalit themeltar to shoqërisë me vendimin e Asamblese se Pergjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

Neni 8

Transferimi i pjeseve te kapitalit dhe e drejta e parablerjes

- 1) Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, sipas nenit 73 te ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".
- 2) Ne rast transferimi te pjeseve te kapitalit no çdo lloj forme ne favor te personave te tjere nga ata te parashikuar me siper, si me shperblim ashtu edhe pa shperblim, me çdo kusht, duke perfshirë edhe dhurimin, ortaket e tjere gezojne te drejten e parablerjes mbi keto pjesë kapitali.
- 3) Ne nje rast te tille ortaku qe do te transferoje pjeset e tij te kapitalit duhet t'i njoftoje ortaket e tjere, me leter rekomande, mbi synimin per shitjen, çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e bleresit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes i referohet te gjitha pjeseve te kapitalit ofruar per shitje.



- 4) Ortaket do te kenë ne dispozicion 15 (pesembedhjete) dite nga marrja e letres rekomande, per t'i komunikuar ortakut qe transferon pjeset e kapitalit, synimin e tyre per te ushtruar apo jo te drejten e parablerjes. Ne rast se ata nuk pergjigjen ne afatin e caktuar, prezumohet se kane hequr dore nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 5) Ne rast se oferta pranohet nga disa ortake, pjeset e kapitalit te ofruara nga ortaku qe transferon pjeset e kapitalit, do te ndahen nga ortaket pranues, ne te njejtien mase me pjeset qe ata zoterojne, perveç rastit kur ka nje marreveshje te kundert. Në asnje rast, pranuesi i ofertes nuk mund te ushtroje pjeserisht te drejten e parablerjes.
- 6) Ne rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, pjeset e kapitalit mund t'i transferohen te treteve plotesisht apo pjeserisht, me vendimin e Asamblese qe perfaqëson te pakten 3/4 (tre të katërtat) e kapitalit themeltar.
- 7) Ne rast te transferimit të pjeseve te kapitalit per shkak trashegimie mortis causa ortaket e tjere kane te drejte te shprehin pelqimin e tyre per ortaket e rinj. Nese ortaket e Shoqerise nuk jepin pelqimin e tyre per ortaket e rinj pjeset e kapitalit mund t'i transferohen te treteve plotesisht apo pjeserisht, me vendimin e Asamblese qe perfaqeson te pakten 3/4 (tre te katertat) e kapitalit themeltar.

KREU III ASAMBLEJA DHE ADMINISTRATORËT

Neni 9 Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

- 1) Organi vendimmarres i Shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve.
- 2) Vendimet e Asamblese se Zakonshme, per te cilat kerkohet nje shumice e thjeshte, jane te vlefshme nese jane te pranishem ne mbledhje ortaket qe perfaqesojne te pakten 25% (njëzetë e pesë përqind) te te gjithe kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblese se zakonshme, per te cilat kerkohet nje shumice e kualifikuar, jane te vlefshme nese jane te pranishem ne mbledhje ortaket qe perfaqesojne te pakten 50% (pesedhjete perqind) te te gjithe kapitalit themeltar.
- 3) Nese Asambleja nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi te permendur ne pikën 2, të nenit 11, te ketij statuti, Asembleja do te mbidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.
- 4) Asambleja e zakonshme vendos me shumice te kualifikuar prej 3/4 te votave te ortakeve te pranishem ne lidhje me ndryshimin e statutit, rritjen dhe zvogelimin e kapitalit, shperndarjen e fitimit, riorganizimin dhe zgjidhjen e shoqerise. Ne te gjitha rastet e tjera, perveç sa eshte parashikuar ne Ligj dhe ne statut, Asemblea vendos ne mbledhjen e zakonshme me voten e shumices se ortakeve te pranishem.

Neni 10 E drejta e pjesemarrjes dhe e votes

- 1) Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamble, te paraqese mendimin e tij dhe te jape aq vota sa eshte numri i pjeseve te kapitalit qe ai zoteron.
- 2) Çdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga nje person tjeter jo-ortak, i pajisur me prokure me shkrim, me anen e se cilës mund te jape voten e tij.
- 3) Ortaku nuk mund te leshoje prokure per votim per nje pjese te kapitalit qe zoteron, ne qofte se voton personalisht per pjesen e mbetur.

Neni 11
Thirrja e Asamblese se Përgjithshme

- 1) Asambleja e Ortakeve thirret te pakten nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vtit financiar per miratimin e bilancit, te raportit te Administratorit, ekspertit kontabel si dhe inventarit.
- 2) Asambleja mund te thirret ne çdo moment nga nje prej Administratoreve ose nga nje ose disa prej ortakeve qe perfaqesojne me shume se 5% (pese perqind) te kapitalit themeltar.
- 3) Asambleja duhet te thirret nepermjet njoftimit me leter rekomande qe duhet t'u dergohet ortakeve - ne adresen qe rezulton ne Librin e Ortakeve - dhe ekspertit kontabel (nese eshte emeruar), te pakten 7 (shtate) dite perpara mbledhjes se Asamblese. Thirrja duhet te permabwe informacion mbi llojin e Asamblese, mbi çështjet qe do te trajtohen dhe per të cilat do te merret vendim, mbi vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte.
- 4) Asambleja mund te thirret edhe jashte selise se Shoqerise.
- 5) Mbledhjet e Asamblese mund te mbahen edhe nepermjet telekonferences dhe videokonferences, me kusht qe te gjithe pjesemarresit te mund te identifikohen dhe t'u lejohet atyre te ndjekin diskutimin dhe te nderhyjne ne momentin e trajtimit te argumenteve; pasi të jene verifikuar keto kerkesa qe duhet te rezultojne ne procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari me të cilin duhet te ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 6) Asambleja do te thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formalitetave te njoftimit, ne rast se jane te pranishem ortaket qe perfaqesojne te tere kapitalin themeltar.
- 7) Asambleja vendos mbi ndryshimet ne Statut me voten pro te ortakeve që perfaqesojne te pakten 3/4 (tre te katertat) e kapitalit themeltar.
- 8) çdo Asamble drejtohet nga nje ortak ose ndonje person tjeter i caktuar nga e njejtë Asamble. Per pasqyrimin e vendimit Asambleja emeron nje Sekretar, qe mund te jete edhe jo-ortak.
- 9) Vendimet e Asamblese duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblese dhe nga Sekretari.

Neni 12
Administrimi

Administratoret e shoqerise emerohen:

- Znj. Besmira Rrika, shtetase shqiptare, e lindur në Zheje - Kruje, më 22/10/1992, banues në Tirane, madhore, me zotesi te plote për të vepruar, i pajisur me leternjofitim me numer: Nr. J26022085W, emerohen per nje afat 5 (tre) vjeçar dhe



- 1) Shoqeria administrohet nga të pakten 1 (nje) Administrator dhe maksimumi 3 (tre) Administratore, të cilët qëndrojnë në detyrëderi ne revokimin apo doreheqjen, per një periudhe maksimale prej 5 (pese) vjetesh.
- 2) Perfaqesimi ligjor i Shoqerise i besohet Administratoreve, bashkarisht apo veçmas.
- 3) Administratoret mund te emerojne perfaquesues te posaçem per veprime apo kategori te caktuara veprimesh.
- 4) Administratorët shperblehen ne baze të skemes se vendosur nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me parashikimet e Nenit 97 te Ligjit.
- 5) Asambleja e Pergjithshme mund të parashikoje perfitime, nepermjet shpërblimeve

KREU IV
VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 13
Viti finanziar dhe bilanci vjetor

- 1) Viti finanziar Fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit;
- 2) Viti i pare finanziar fillon ne daten e regjistrimit to Shoqerise ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit dhe perfundon me 31 dhjetor te te njejtit vit;
- 3) Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabel te autorizuar (nese eshte emeruar) miratohen nga Asambleja me shumicen e percaktuar sipas ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare";
- 4) Miratimi i dokumentave qe lidhen me vitin finanziar duhet te behet brenda 6 (gjashte) muajve qe nga fundi i vitit finanziar.

Neni 14
Fitimet

- 1) Fitimet qe rezultojne nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% (pese perqind) qe caktohen per rezerven ligjore deri ne 10% (dhjete perqind) e kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu te gjitha shumat qe Asambleja vendos t'i vere menjane, u shperndahen ortakeve ne proporcione me pjeset e kapitalit themeltar te zoteraura.
- 2) Asambleja mund te vendose edhe zbritje te veçanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo dhe shtyrjen e shperndarjes se fitimeve, plotesisht ose pjeserisht, per vitet financiare te ardhshme.

KREU V
SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 15
Prishja



- 1) Shoqeria prishet me perfundimin e afatit te parashikuar nga Statuti, ose perpara perfundimit ne rastet e parashikuara nga ligji, ose me ane te nje vendimi te Asamblese se Ortakeve, me shumicen e kerkuar per ndryshimet ne statut;
- 2) Shoqeria nuk prishet ne rast te humbjes se zotesise per te vepruar, pazotesise juridike, vdekjes, ose falimentimit te ortakeve.

Neni 16 Likuidimi

- 1) Ne rast prishje, Shoqeria duhet te likuidohet.
- 2) Per te administruar kete procedure, Asambleja emeron nje ose me shume likuidatore, te cilët paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit te Shoqerise, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohen e nevojshme per te perfunduar likuidimin.
- 3) Me perfundimin e procedures se likuidimit, Asambleja do te vendose mbi bilancin finansiar perfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi perfundimin e procesit te likuidimit.
- 4) Pas pagimit te kreditoreve dhe mbledhjes se kredive, likuidatori do t'i shperndaje te ardhurat perfundimtare te likuidimit ortakeve, ne proporcione me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 17 Zgjidhja e mosmarreveshjeve

- 1) Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me interpretimin dhe/ ose zbatimin e ketij statuti dhe aktit te themelimit, si edhe ato qe mund te lindin ne per gjithesi midis ortakeve (perveç atyre personale apo jashte Shoqerise) ose midis nje apo me shume ortakeve dhe Shoqerise, do te zgjidhen ne menyre miqesore dhe do te diskutohen ne menyre te drejtperdrejte nermjet paleve te interesuara.
- 2) Ne rast se nuk arrihet nje marreveshje atehere palet do ti drejtohen Gjykates.

**ORTAKU I VETEM
BESMIRA RRIKA**

Besmira Rrika